

**FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS
FUDBALSKI SAVEZ KOSOVA
FOOTBALL FEDERATION OF KOSOVA**



**PROPOZICIONETEGARAVE
Për Superligë, dhe Ligen e parë
Kampionati i Kosovës në Futsall ; 2022 - 2023**

SHTATOR, 2022

**Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, bazuar në nenin 57 p. 1) nën e), e Statutit të FFK-së dhe me
propozim të Komisionit të Futsali-it, aprovon:**

**PROPOZICIONET E GARAVE për Super ligë, dhe Ligen e parë
Kampionati i Kosovës. 2022/2023**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Në bazë të Vendimit të KE së FFK-së për sistemin e garave të rregullta marrin pjesë të gjitha klubet e licencuara në Futsall

Numri i ekipeve pjesëmarrëse është:

- Super liga 10 klube ose - Super liga 9
- Liga e parë 12 klube ose - Liga e Parë 11

Neni 2.

Garat i udhëheq Komisioni i Futsal-it në kuadër të FFK-së (Në tekstin e mëtejme Komisioni)

Garat e rregullta në kuadër të FFK-se janë;

Kampionale dhe për kupë të Kosovës.

Neni 3.

Garat luhen në dy pjesë Super liga dhe Liga e parë në një pjesë 2 x 20 min.

lojë efektive (vajtje ardhje).

Pjesa e parë: Sistemi i dyfishtë me pike (në baze të gjirove) renditja e ndeshjeve caktohet me short më numrat me aplikim të tabelës së Bergerit.

Pjesa e dytë: Play off-it me 4 (katër) ekipet me renditje të para, ashtu që përparësinë e fushës e ka ekipi i pozicionuar më lartë. Në rast se dy ose më shumë klube kanë renditje identike pas pjesë së parë të garave aplikohen rregullat nga Neni 41. i këtyre propozicioneve.

Luhet në dy ndeshje të fituara, dhe në rast të barazimeve në të gjitha ndeshjet individuale, luhen vazhdimet dy here nga 5 minuta, dhe nëse edhe në atë rast rezultati është i barabartë ekzekutohen penaltitë sipas "Rregullores së FIFA-së" (ekzekutohen nga 5 (pesë) penalti.

Qiftet caktohen në bazë të kësaj renditjeje :

Gjysmëfinalja : 1.- 4, dhe 2,- 3.

Fituesit mbajnë vendet e tyre të fituara .Gjatë gjithë ndeshjeve përfundimtare ekipi më mire i renditur nga pjesa e parë e kampionatit mban të drejtën e nikoqirit në ndeshjen e parë dhe ndeshjen e tretë eventuale.

Kampioni në Super ligë vendoset pas përfundimit të garave të Play off-it.

Dy ekipet e renditura në vendin e 9, 10 **(nese janë 9 ekipe nga liga largohet vetem nje)**, do të bien nga Super liga në Ligen e parë. Ndërsa dy ekipet e renditura në pozitat 1 dhe 2 të Ligës së parë automatikisht kalojnë në Super ligë. Fillimin e kampionatit të Super Ligës dhe Ligës së parë të Kosovës e cakton Komisioni i Futsal-it

Neni 3a,

Garat e Kupës të Kosovës zhvillohen nga një ndeshje në mes veti deri në gjysmë finale, ndërsa gjysmë finalja luhen dy ndeshje (vajtje ardhje).

Pjesëmarrëse në kupë janë të obliguara të gjitha ekipet e Super ligës dhe ligës së parë të Futsall-it të Kosovës. Mos pjesëmarrja në kupë, klubet sanksionohen me dënim në të holla prej 200-400 euro.

Neni 4.

Të gjitha ndeshjet e futsall-it të Kosovës luhen ditën e Premte e shtune dhe e hëne mes orës 18:00 dhe 21:00 dhe të dielën mes orës 16:00 dhe 21:00, për ndryshim të orarit me marrëveshje mes ekipeve dhe me vendim të Komisarit të Garave.

Komisari i Garave në rastet e caktuara (pjesëmarrja e klubeve në garat e UEFA-së etj.) të lejoj ndërrimin e ditës dhe kohës së ndeshjeve të caktuara para luajtjes së gjiros së radhës, me kusht që ndeshjet të kryhen para datave të caktuara, respektivisht më së voni para luajtjes së gjiros së radhës, në rast se Komisioni i Futsall-it me arsye nuk vendos ndryshe.

Ndeshjet të cilat luhen në bazë të marrëveshjes e të Drejtës TV dhe transmetohen drejtpërdrejte mund të luhen jashtë ditëve dhe orëve të caktuara, me kërkesë të kontraktuesit , vendimin e sjell Komisar i Garave (4) katër ditë para luajtjes së ndeshjes.

Të gjitha ndeshjet e dy gjirove të fundit luhen në kohën e njëjtë sipas kalendarit të garave, përjashtimisht me kërkesën e partnerit të drejtave TV ose me arsye disa ndeshje mund të luhen në kohë të ndryshme, vetëm nëse ato ndeshje nuk vendosin direkt në renditjen e klubeve tjera.

Klubi vendas i cili me arsye nuk mund ta organizoj ndeshjen në fushën e vet, obligohet që (4) katër ditë përpara ndeshjes , të caktoj qytetin dhe fushën ku do të jetë nikoqir i ndeshjes.

Nëse klubet me arsye kërkojnë ndryshimin e terminëve të ndeshjes gjatë kampionatit, obligohen që marrëveshjen me shkrim t'ia sjellin komisarit të garave më së paku (4) katër ditë para luajtjes së ndeshjes të përcaktuar me kalendarin e garave.

Në raste të jashtëzakonshme (fatkeqësive elementare e të ngjashme), Komisar i Garave mund ta shkurtoj afatin në (2) dy ditë para luajtjes së ndeshjes ose të bëj ndryshimin e nikoqirit për ndeshjen e caktuar.

Neni 5.

Klubet e Futsall-it kanë të drejtë ndryshimi të luajtjes së ndeshjeve të caktuara nëse japin më shumë se 1 (një) lojtarë në Kombëtaren e Kosovës "A".

ORGANIZIMI I NDESHJEVE-OBLIGIMET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 6.

Organizimin e ndeshjeve e bëjnë ekipet që luajnë në fushën e tyre dhe obligohen për mbarëvajtjen e organizimit të ndeshjes.

Ekipi vendas është përgjegjës për rendin dhe sigurinë para, gjatë dhe pas ndeshjes dhe do të jap përgjegjësi për çfarëdo incidenti, dhe mund të dënohet komfor me dispozitat e Rregullores Disiplinore të FFK-së.

- (sigurimin e lojëve e bene Policia e Kosovës, me marrëveshje të dy ekipeve munden edhe sigurimi privat. Nëse në ndeshjet zyrtare mungon sigurimi (Policia) dhe nuk ka dëshmi për lajmërim të Policisë ekipi vendas e humb ndeshjen).

Nëse shkaktohen dëme, klubi vendas lajmëron Komisionin e Futsall-it dhe FFK-në 20 min. Pasi ekipa kundërshtarë ka lëshuar zhveshtoren, nga kërkesa për kompensim të dëmit të shkaktuar në ndeshjen e organizuar. Ekipi vendas është i obliguar që ndeshjen ta incizoj me dy CD HD kamera sipas vendimit të Komisionit të Futsall-it, dhe DVD t'ia dorëzoj delegatit menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, kurse incizimin nga dy kamerat dhe procesverbalin e ndeshjes ta përgatis për nevojat e shtëpive TV, nëse ndeshja do të transmetohet ose transmetimi i incizimit. Obligohet incizimi edhe pas ndeshjes ,përshëndetja e lojtarëve dhe personave zyrtar, gjersa nuk e lëshojnë parketin. Nëse ndeshjen e përcjell kontrollori i referimit klubi vendas obligohet që t'ia dorëzoj një ekzemplar të DVD pas përfundimit të ndeshjes. Në rast të mos përmbajtjes së dispozitës së lartë përmendur klubi do të ndëshkohet komforë Rregullores Disiplinore të FFK-së. Klubi vendas është i obliguar që të siguroj personin i cili do ta këshilloj gjyqjetarin e katërt (4)-kohëmatësin me udhëheqjen e semaforit.

Klubi vendas obligohet që të siguroj palestrën për nxehjen e ekipeve një orë para fillimit të ndeshjes.

Klubi vendas obligohet që të siguroj zërimin dhe t'i paralajmëroj lojtarët dhe zyrtarët e dy ekipeve para fillimit të ndeshjes.

Udhëheqësit e klubeve ku luhet ndeshja obligohen që të ofrojnë ndihmën e nevojshme për organizimin e suksesshëm të ndeshjes.

Neni 7.

Klubi mysafir obligohet që më kohë të lajmëroj ekipin vendas nëse ka vonesë gjatë rrugës, për kohën e arritjes në vend, gjegjësisht para palestrës, .

Ekipi vendas obligohet që të ndërmarr gjitha masat për sigurinë e gjyqtarëve, delegatit dhe ekipit mysafir, më arritjen, gjate ndeshjes dhe gjerë tek largimi nga palestra me mjetin e caktuar të transportit.

Klubi vendas obligohet që në të gjitha ndeshjet kampionale të siguroj shërbimin shëndetësor dhe automjetin e ndihmës së parë ose automjetin adekuat zëvendësues.

Klubi vendas bart hargjimet e personave zyrtar (gjyqjetarve dhe delegatit).Pagesa e personave zyrtar (gjyqjetarve dhe delegatit), kryhet para fillimit të ndeshjes. Nëse nuk është e rregulluar në ndonjë formë tjetër. Nëse ekipi nikoqire nuk i kryen obligimet ndaj personave zyrtar ndeshjen e radhës si vendas nuk mundet të zhvilloj.

Neni 8.

Gjithë ndeshjet e Futsall-it luhen obligativisht në palestra të cilat i përshtaten:

-rregullores "Rregullat për lojën Futsall-it" dhe sipas Rregullit 1. Parmakët duhet të jenë larg së paku 1.5 metra nga vijat e fushës me mburojë nga materialet e buta, stolin për lojtarë rezervë dhe vendin e delegatit gjithashtu 1.5 metra të larguar nga vijat e fushës.

-rregullores për garat e futbollit të FFK-së. Klubet obligohen që 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para fillimit të garave që të paraqesin Komisarit të garave palestrën se ku do ti zhvillojnë ndeshjet.

Dimensionet e palestrës për zhvillimin e lojës duhen të jenë minimum 20 m e gjerë dhe 38 m e gjatë. Te gjitha klubet duhet të kenë dëshminë e objektit sportiv (palestrës). Konsiderohet se klubi ka objektin sportiv, nëse ka dëshminë e pronësisë, vërtetimin e menagjimit, kontratën e blerjes ose kontratën mbi shfrytëzimin e objektit sportiv për periudhën e garave. Palestra e paraqitur për ndeshje duhet të ketë miratimin me shkrim për luajtjen e ndeshjeve, e dhënë nga Komisioni për fusha dhe palestra, të cilën e emëron Komisioni për Futsal, KE i FFK-së cakton kriteret komfor rregulloreve të FFK-së.

Neni 9.

Për luajtjen e ndeshjeve të Futsall-it klubi vendos obligohet që të siguroj tre (3) topa. Karakteristikat e topave duhet të jenë sipas "Rregullores për Futsal", Komfor Rregullës 2.

Neni 10.

Klubi vendos obligohet që të siguroj barelën dhe katër persona për bartjen e lojtarëve të lënduar jashtë fushës së lojës.

Neni 11.

Gjatë ndeshjeve kampionale, në fushë afër terrenit, në bankinë mund të gjinden personat zyrtarë:

- Zyrtari për siguri
- Mjeku me kualifikimin e duhur (obligativ për vendasin)
- Përfaqësuesi i klubit i pajisur me logon e klubit
- Krye trajneri, më licencë të FFK-së i pajisur me logon e klubit
- Ndihmës trajneri i pajisur me logon e klubit.
- Fizioterapeuti me pajisje sportive me shenja të klubit
- Lojtarët rezervë (së paku 3 e më së shumti 9) (të veshur me pajisje sportive dhe me markerin (tregerin) të cilin ia japin lojtarit që e ndërrojnë në lojë)

Pas bankinës së lojtarëve reserve, jashtë fushës së lojës, mund të qëndrojnë vetëm:

- Mjeku kujdestar me shenjë të posaqme, 2-4 persona me barelë, e shenjëzuar posaçërisht për bartjen e të lënduarve jashtë fushës,
- Nëse është e nevojshme, shërbyesit e topave me ngjyrë dalluese nga pjesëmarrësit, fëmijë 10-12 vjeçar.
- Shërbimi mjekësor dhe vozitësi i ndihmës së shpejtë
- Fotoreporterët dhe gjiruesit (kameramanët) me shenja të caktuara,
- Numri i mjaftueshëm i rojeve dhe sigurimit dukshëm të shenjëzuar
- Persona (së paku 2) për pastrimin e fushës

Secili klub duhet të caktoj personin i cili do ta përfaqësoj në ndeshje. Përfaqësuesi duhet të ketë autorizimin e shkruar nga personat përgjegjës të klubit dhe ia dëshmon delegatit para fillimit të ndeshjes. Përfaqësuesi i klubit delegatit para ndeshjes i dorëzon autorizimin, listën e lojtarëve dhe ID kartelat e lojtarëve, si dhe obligativisht lejet për punë të trajnerit, mjekut dhe

fizioterapeutit. Përfaqësuesi i klubit merr pjesë në identifikimin e lojtarëve, në futjen e shënimeve në procesverbal dhe në nënshkrimin e procesverbalit.

Vetëm një person mund të qëndroj në këmbë për të udhëhequr ekipin.

Lëvizja e trajnerit ose njërit nga personat zyrtar lejohet vetëm në kuadër të hapësirës teknike të vijëzuar, sipas Rregullores së FIFA-së “Rregullave të Futsall-it”, komfor Rregullit 1.

Lojtarët mund të nxehen në hapësirën të përcaktuar nga gjyqjëtaret e ndeshjes sipas “Rregullave të Futsall-it”, komfor rregullit 3.

Gjatë pushimit njëminutësh lejohet që lojtarët që kanë luajtur të ulen në bankën e rezervistëve ,kurse gjithë lojtarët rezervë duhet hyrë në pjesën e hapësirës teknike.

Në rast se nga bankina përjashtohet ndonjë nga personat zyrtar ose lojtarët rezervë ata sanksionohen sipas “Rregullave të Futsal-it”, komfor Rregullës 12(dalin në publik).

Neni 12.

Ekipi vendas obligohet që të siguroj hapësirën ndarëse në tribuna (së paku 5% të kapacitetit të përgjithshëm të palestrës) për tifozët mysafir, dhe në rast të paralajmërimit të numrit më të madh të tifozëve mysafir, të ndaj arkën e posaçme për atë sektor të publikut.

Ekipi mysafir obligohet që së paku 48 orë para ndeshjes që të njoftoj klubin mysafir për mënyrën e organizimit të ardhjes së numrit më të madh të shikuesve.

Për incidente dhe ekcese që ndodhin në pjesën e rezervuar për ekipin mysafir, ekipi mysafir ka përgjegjësinë objektive dhe sanksionohet sipas Rregullores Disiplinore.

Neni 13.

Para hapjes së Palestrës ekipi vendas obligohet që në vendin e dukshëm të vendos flamurin e Republikës së Kosovës dhe flamurin e sponsorëve eventual të FFK-së .Gjatë mbajtjes së ndeshjeve klubi vendas obligohet që rreth fushës të vendos gjithë reklamat sipas Marrëveshjeve të FFK-së dhe sponsorëve eventual. Ndashja nuk do të filloj gjersa nuk sigurohen kushtet e parapara më së voni 15 minuta nga caktimi i fillimit të ndeshjes.

Promovimi ose shpallja në çfarëdo forme e porosive politike ose ndonjë aktiviteti politik brenda dhe në afërsi të palestrës rreptësishtë ndalohet para, gjatë ose pas përfundimit të ndeshjes.

Klubi vendas obligohet që të veproj në harmoni me rregullat e këtij Neni në të kundërtën ndeshja nuk do të zhvillohet, dhe klubi vendas do të bartë pasojat.

Neni 14.

Klubet janë përgjegjëse për sjelljen e lojtarëve të tyre, personave zyrtar, anëtarëve, shikuesve dhe çdo personi tjetër që kryen funksionin në ndeshje në emër të klubit.

E DREJTA E PJESËMARRJES

Neni 15.

Në ndeshje kanë të drejtë pjesëmarrjeje gjithë lojtarët e regjistruar në programin e regjistrimit **“FIFA Connect Registration Platform”**, që kanë moshë mbi 17 vjeçare dhe kanë të drejtë pjesëmarrjeje në ndeshje kampionale, bazuar vendimit të Rregulloreve të FFK-së, Rregullores për Regjistrimin e Klubeve dhe Lojtarëve dhe Rregullores mbi Statusin e Lojtarit Përrjashtimisht në ndeshje kampionale mund të marrin pjesë edhe lojtarët me moshë 16 vjeçare, me lejen e komisionit special mjekësor për pjesëmarrje në ekipin e seniorëve. Leja duhet të vërtetohet tek organi kompetent dhe vlen 6 muaj nga dita e lëshimit.

Lojtarët të regjistruar në çfarëdo kategorie të futbollit të madh (të huaj dhe vendor), nuk kanë të drejtë të luajnë për ekip të futsal-it.

Në ndeshjet e Futsall-it mund të paraqiten vetëm lojtarët e shpallur të shëndetshëm, dhe kjo evidentohet në regjistër, të vërtetuara dhe vulosura nga institucioni shëndetësor ku është kryer kontrollimi mjekësor. **(kontrollimi mjekësor duhet të behet Qendren mjekësor sportive).**

Afati i vlefshmërisë së kontrollit mjekësor vlen 6 (gjashtë) muaj nga dita e nënshkrimit në Regjistër. Nëse mjeku e shpall të shëndetshëm lojtarin për një afat të caktuar kohor, më të shkurtër se ai në këtë nen, atë e shënon në regjistër, dhe lojtari mund të luaj aq ditë deri sa nuk kalon afati i shënuar.

Lojtari i cili nuk është trajtuar nga mjeku, respektivisht nuk e ka të kryer kontrollin mjekësor në afatin e caktuar ose i është ndaluar paraqitja nga ana e mjekut, si dhe lojtari të cilit kontrolli mjekësor nuk iu ka shënuar në regjistër, dhe nëse delegatit nuk ia dëshmon vërtetimin e kontrollit mjekësor, nuk ka të drejtë loje.

Lojtari i cili nuk ka të shënuar në regjistër kontrollimin mjekësor mund të luaj në ndeshje vetëm atëherë kur në kërkesën e delegatit, ka me vete vërtetimin zyrtar të kontrollimit mjekësor. Vërtetimi i kontrollimit mjekësor nga ky nen duhet të lëshohet nga ana e mjekut të autorizuar, dhe ka të bëjë me lojtarin e caktuar dhe vlen më së gjati 15 ditë nga dita e lëshimit.

Në ndeshje kampionale nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje lojtarët që janë të suspenduar, më ndalim loje dhe me ndalimin automatik për shkak të tri vërejtjeve (tre kartuça të verdhë).

Ndëshkimin automatik të ndalesës për një ndeshje të shkaktuar nga tri vërejtje lojtari e kryen me mos lojë në ndeshjen e parë kampionale të radhës.

Pas përfundimit të pjesës së parë të kampionatit (18 gjiro) fshihen vërejtjet e lojtarëve të cilët janë me dy kartuça, ndërsa lojtari që ndëshkohet në xhiron e 18 dhe i bene 3 kartuça (java e fundit lojtari i ndëshkuar) automatikisht pushon lojën e parë në garat play off ose në gjiron e parë kampionale të vitit të ardhëm, po ashtu kartuçi i kuq bartet në kampionat kupë dhe playoff dhe në kampionatin e vitit të ardhshëm. Ndersa kartuçi i kuq i dhënë pasë dy të verdhëve nëse merret në garat e kupës vlen vetëm në kupe, nëse merret ne garat kampionale vlen vetëm në kampionat.

Në garat e kupës dhe në play off lojtaret që ndëshkohen me 2 kartuça të verdhë automatikisht pushon lojën e radhës.

Komisari i garave obligohet, ne bazë të procesverbaleve, të mbaj evidencën e kartonëve dhe ti paraqes në buletinin javor për secilin klub.

Administrata e klubit mban përgjegjësin e lojtareve të vet të ndëshkuar.

Klubi i Futsall-it mund t’ia fillojë ndeshjen nëse ka prezent 8 (tetë) lojtarë të aftë dhe me pajisje sportive, te cilët shënohen në procesverbal. Ndeshja nuk mund të filloj me më pak se 8 (tetë) lojtarë. Lojtaret të cilët nuk kanë të drejtë loje nuk llogariten në numrin e nevojshëm të lojtarëve.

Secili klub në garat e Futsall-it obligohet që ndeshjen ta luaj me ekipin e tij më të mirë.

Klubet e Futsall-it obligohen që të paraqesin gjithë lojtarët pjesëmarrës gara në dy kopje njëra i jepet Komisionit të Futsail-it, kurse i dyti Komisarit të garave të Futsall-it

DELEGATI I NDESHJES

Neni 16.

Klubet mund të kenë 3 (tre) , lojtar shtetas të huaj. Lojtaret nga alineja e lartë nuk konsiderohen lojtarët me dy nënshtetësi prej të cilave njëra është kosovare ose lojtarët me nënshtetësinë e EU ose Hapësirës Ekonomike Evropiane. Lojtaret shqiptar nga rajoni (Shqipëri, Maqedoni, Mali i Zi si dhe nga Serbia lindore) nuk llogariten si lojtar te huaj

Neni 17.

Në ndeshjet kampionale mund të paraqiten gjere nëntë (9)lojtarë rezervë sipas “Rregullave të Futsali-it” , komfor Rregullës 3, zëvendësimet nuk janë të kufizuara.

Neni 18.

Për çdo ndeshje kampionale Komisari i garave cakton delegatin i cili përfaqëson udhëheqësit e garave, kontrollon vlefshmërinë e ID kartelave, licencat e personave zyrtar dhe të përgjegjës për kontrollin e organizimit të plotë të ndeshjes. Delegati është i obliguar që në palestër të jetë një orë para fillimit të ndeshjes, dhe të udhëheq takimin me personat zyrtar dhe përfaqësuesit e klubeve para ndeshjes. Delegati obligohet që procesverbalin e kompletuar të ndeshjes (procesverbalin dhe raportin e ndeshjes) ta përpiloj menjëherë pas përfundimit të ndeshjes në prezencën e dy përfaqësuesve të klubeve të cilët e vërtetojnë me nënshkrime. Procesin e kompletuar në dy kopje, DVD e ndeshjes, raportin e “Fair Play” dhe llogaritë e mëditjeve dhe hargjimeve të personave zyrtar, t’ia dorëzoj Komisarit të garave në afatin prej 24 orësh pas ndeshjes Nga një ekzemplar të procesverbalit të plotë, delegati ia dorëzon personave zyrtar të klubeve me përmbylljen e procesverbalit .Delegati obligohet që ekzemplarën e procesverbalit me telefax të cilin e siguron klubi vendas t’ia dërgoj Komisarit posa mbaron ndeshja dhe me telefon ta njoftoj Komisarin për rezultatin e ndeshjes dhe parregullsitë eventuale.

Delegati obligohet që Brenda afatit 24 orësh pas ndeshjes së luajtur që të dërgoj protokollin e ndeshjes Komisarit te garave. Nëse në ndeshje nuk vjen Delegati i ndeshjes, të gjitha përgjegjësitë i merr gjyqgjëtarë i Parë.

Secili klub në garat e Futsall-it obligohet që ndeshjen ta luaj me ekipin e tij më të mirë.

Klubet e Futsall-it obligohen që të paraqesin gjithë lojtarët pjesëmarrës gara në dy kopje njëra i jepet Komisionit të Futsail-it, kurse i dyti Komisarit të garave të Futsall-it.

Neni 19.

Për gjitha ndeshjet kampionale është obligim përpilimi i procesverbalit të ndeshjes sipas formularit të përcaktuar nga ana e FFK-së. Nëse për shkaqe të arsyeshme procesverbali i ndeshjes nuk mund të shkruhet në sistemin aplikativ, klubi vendas obligohet që delegatit të ndeshjes t’ia vë në dispozicion kompjuterin me lidhjen e internetit, numër të mjaftueshëm të formularëve të ndeshjes së luajtur dhe të siguroj shtypjen e tyre me kompjuter, si dhe t’i jepet

ndihma e nevojshme për përpilimin e procesverbalit, gjatë marrjes në pyetje të personave të caktuar, dhe përdorimi i fax pajisjes. Delegati, gjyqtaret dhe përfaqësuesit zyrtar të klubeve obligohen për dhënien e rregullt të shënimeve në procesverbal, dhe obligohen që t'i nënshkruajnë në kopjen e shtypur. Delegates i cili nuk e kryen detyrën në pajtim me rregulla ose nuk i përmbahet konkluzave dhe udhëzimeve nga organet përgjegjëse do të suspendohet nga një gjiro ose më shumë gjiro, kurse në përsëritje të gabimeve do të fillohet edhe procedurë disiplinore. Për suspendime përgjegjës është Komisari i garave.

REFERËT E NDESHJEVE

Neni 20.

Për gjithë ndeshjet kampionale gjyqtaret i cakton Komisari për Refer i Futsall-it së Kosovës. Ndeshjet i referojnë 3 gjyqtar. Në dy skajet anësore të fushës nga 1(një),gjersa . gjyqtari i tretë është në funksion të Matësit të Kohës. gjyqtaret obligohen që në fushë të jenë një orë para fillimit të ndeshjes ,ta kontrollojnë fushën sipas Rregullave të “Futsali-it” komfor Rregullit 1 dhe 2.Nëse gjyqtart konstatojnë se fusha nuk është e përshtatshme për lojë dhe se ndeshja nuk mund të zhvillohet, obligohen që ta njoftojnë delegatin e ndeshjes dhe ai për këtë do ta njoftoj Komisararin e Garave.

- Mëditjet e gjyqtareve të Super ligë janë; 100 euro
- Mëditjet e Delegatit të Super ligës është 80 euro
- Mëditjet e gjyqtarit të tretë në Supër ligë është 50 euro
- Mëditjet e kontrollorit në Supër ligë si dhe në ligë të parë është 1x 50 euro
- Mëditjet e gjyqtarit të Ligës së pare janë 80 euro
- Mëditjet e Delegatit në Ligën e pare është 70 euro

Neni 21.

Gjyqtaret obligohen që në procesverbal të ndeshjes së luajtur të shënojnë vërejtjet e tyre, kartonët e verdh dhe te kuq dhe procesin ta nënshkruajnë. Gjyqtaret janë të obliguar që në procesverbal të shënojnë fletëparaqitjen ndaj lojtarëve dhe punëtorëve sportive për gabimet e kryera, para, gjatë dhe pas ndeshjes, njëherë janë të obliguar që të japin raport më shkrim për shkelësit të rregullave dhe te ja dorëzojnë delegatit të ndeshjes ose Komisararit te Garave.

Neni 22.

Ndeshjet i referojnë gjyqtaret nga regjistri i gjyqtareve të Futsall-it në edicionin garues 2022/2023, sipas “Rregullave të Futsali-it”, komfor Rregullës 5 dhe 6. gjyqtaret obligohen që në ndeshje të vijnë me rroba të përshtatshme. Nëse në ndeshje nuk vjen ndonjëri nga gjyqtaret e caktuar, procedura e zgjedhjes shkon sipas kësaj mënyre: Nëse mungon gjyqtari i (1) parë, rolin e merr gjyqtari i (2) dytë. Ose gjyqtari i (3) tretë, respektivisht ai i cili është në grupin më kualitativ. Nëse janë të një grupi gjyqtari i (1) pare, bëhet ai me përvojë më të gjatë. Nëse në publik është ndonjë nga gjyqtaret i cili është në listën e gjyqtareve, ai e merr detyrën e gjyqtarit të (2) dyte apo te (3) tret, varësisht prej nevojës.

Nëse klubet nuk mund të merren vesh, delegati i ndeshjes vendos se cili gjyqjës do të referoj (duke plotësuar kushtet nga lista e gjyqjësareve) , dhe e gjithë kjo duhet të shkruhet në procesverbal.

Neni 23.

Gjyqjësari i cili nuk e kryen detyrën në pajtim me rregulla ose nuk i përmbahet konkluzave dhe udhëzimeve nga organet përgjegjëse do të suspendohet nga një gjiro ose më shumë gjiro, kurse në përsëritje të gabimeve do të fillohet edhe procedurë disiplinore . Për suspendime përgjegjës është Komisari i referimit.

Neni 24.

Gjyqjësaret nuk janë përgjegjës për çfarëdo lëndimi të lojtarëve, personave zyrtar ose shikuesve, çfarëdo forme e dëmit material ose humbje e çfarëdollojshme e individit, klubit, ose ndërmarrjes , lidhjes ose organi të ngjashëm, për arsye të ndonjë vendimi të paraparë me Rregullore, në aspekt të veprimeve për mbajtje, luajtje dhe kontrolli të ndeshjes.

FUSHA E LOJËS-KUSHTET PËR LUJATJEN E NDESHJEVE KAMPIONALE

Neni 25.

Ndeshjet e Futsall-it të Kosovës mund të luhen vetëm në palestra të cilat i plotësojnë kushtet sipas “Rregullores së Futsall-it”, komfor Rregullës 1.

Kontrolli i fushës dhe sipërfaqes së lojës duhet të kryhet në prezencë të dy kapitenëve dhe atë në kohën e paraparë për ndeshje. Përgjithësisht, kontrolli mund të kryhet edhe më herët, por ditën e njëjtë dhe me prezencë të kapitenëve të dy ekipeve dhe gjyqjësarin e ndeshjes. Për pa rregullsitë e palestrës dhe sipërfaqes së lojës, për shkak të motit të ligë, ose ndonjë arsye tjetër, që i përket kushteve të jashtëzakonshme, vendosin gjyqjësaret, të caktuar për referimin e ndeshjes.

Gjyqjësarët dhe delegati obligohen që në procesverbalin e ndeshjes të shënojnë jo përshtatshmërinë e palestrës dhe procesverbalin t’ia dorëzojnë Komisarit në afatin prej 24 orësh, më lajmërimin paraprak me telefon gjegjësisht telefaks. Delegati obligohet që për vendimin eventual për jo përshtatshmërinë e palestrës të komunikoj me Komisarin e garave përmes telefoni

Neni 26.

Në fushën e lojës gjatë mbajtjes së ndeshjes ndalohet çfarëdo forme e reklamës nëse nuk është paraqitur dhe aprovuar paraprakisht. Në rrjeta ose në porta nuk mund të vendosen material reklamues ose pajisje (p.sh., kamere, mikrofon etj.). Gjithashtu ndalohet riprodhimi i llogove në sipërfaqe të palestrës (përdorimi i laserëve e ngjashëm).

Neni 27

Secili klub pjesëmarrës në Futsall-in e Kosovës duhet të ketë në pronësi ose kontratë për shfrytëzimin e palestrës e cila është e licencuar për mbajtjen e ndeshjeve kampionale dhe të ketë:

- Sipërfaqen kualitative, pa dëmtime e cila do t'ju shkaktonte lëndime lojtarëve, fushën e lojës me dimensione të përcaktuara dhe të ndare nga shikuesit me gardh të larguar së paku 1,5 metra nga vija e fushës (rekomandohen 3 metra) dhe e mbrojtur me material të butë i cili i siguron lojtarët nga lëndimi. Bankinat për ekipe me më së paku 15 vende dhe tavolinën e ndare për delegatin e

ndeshjes dhe gjyqjëtarin e tretë me pajisjen e përshtuar të nevojshme kalimin e mbrojtur për daljen e lojtarëve dhe personave zyrtar nga teshatorja deri në fushë,

- Së paku 2 (dy) teshatore të ndara për ekipe me banjë me ujë të ngrohtë dhe

Teshatore të posaçme për gjyqjëtar ,dhe hapësirën e ndarë për përpilimin e procesverbalit,

- vendin në tribuna për punë të pa penguar për gazetarë me qasje në internet

- Sipërfaqen e caktuar për kamerat televizive

- Pajisje zërimi

- Semafori elektronik dhe pajisja për shënimin e faulave të akumuluar, (nese semafori nuk punon në marrveshje mes dy ekipeve dhe gjyqjërarëve mund te fillon loja).

Neni 28.

Ekipi vendas obligohet që të siguroj hapësirën për kryerjen e Domingo Kontrollës.

Hapësirën e përbëjnë:

- Hapësira e pritjes, e cila duhet të pajiset me frigorifer me pijet e lejuara dhe gota për pije

- Hapësira me sipërfaqen punuese për plotësimin e formularit dhe punë me mostra

Qasja dhe lokalizimi i hapësirës për kryerjen e doping kontrollës duhen shënuar me mbishkrimin

KONTROLLA E DOPINGUT.

Neni 29.

Ekipi vendas obligohet që të siguroj hapësirën për takimin e personave zyrtar dhe përfaqësuesve të klubeve, e cila mbahet 60 (gjashtëdhjetë) minuta para fillimit të ndeshjes nën udhëheqjen e delegatit të ndeshjes, ku obligativisht marrin pjesë:

- Gjyqjëtaret e ndeshjes

- Personat zyrtar të klubeve, Udhëheqësi i sigurimit të klubit vendas

Në rastet kur e sheh të arsyeshme, delegati mund të kërkoj që në takim të marrin pjesë edhe udhëheqësit e organeve dhe shërbimeve të ndryshme të kyçur në organizimin e ndeshjes.

Komisari i garave në rast nevojës, e posaçërisht tek ndeshjet e rrezikut të lartë, mund të caktoj takimin e personave zyrtar dhe përfaqësuesve të klubeve të mbahet para kohës së përcaktuar nga alineja 1. e këtij neni.

Në takim kryhet kontrolli i gjithë detyrave të kryera në përgatitjen e mbajtjes së ndeshjes, të cilat dalin nga dispozitat e Rregullores së garave, Propozicionet e garave, Vendimeve për siguri në ndeshjet e futsal-it, Ligjit mbi Tubimet Publike, dhe vendimeve tjera të FFK-së.

Neni 30

Ekipi vendas obligohet që të siguroj hapësirën për konferencën eventuale për gazetarë 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes, ku marrin pjesë trajnerët e licencuar të dy ekipeve, si dhe nga një lojtar nga secila ekip pjesëmarrëse (Kapitenët).

NDALESA E PJESËMARRJES PËR SHKAK TË SUSPENDIMEVE

Neni 31.

Ekipi i cila nuk i zhvillon dy ndeshje brenda kampionatit pa kurrfarë arsye e humb te drejtën për vazhdimin e garave – përjashtohet nga organizata e futsal-it. Ekipi i cila nuk e zhvillon një ndeshje pa arsye mund të dënohet me minus 3- 6 pika si dhe me gjobe prej 200 – 400 euro.

TRAJNERËT E FUTSALLIT

Neni 32.

Trajneri dhe ndihmës trajneri mund ta kryejnë funksionin e tyre në ndeshjet kampionale vetëm nëse kanë lejen për punë (Licencë) të lëshuar nga Komisioni i trajnerëve të FFK-së. Nëse delegati gjen se trajneri nuk ka licencë, nuk do ta lejoj pjesëmarrjen e tij në pjesën e lojtarëve e as në bankinën e rezervistëve dhe personave zyrtar, dhe as të shënohet në procesverbal si trajner.

ANKESA

Neni 33.

Ankesat në ndeshje i dërgohen Komisionit të Futsal-it i cili i zgjedh në shkallën e parë

Ankesa në të gjitha bazat duhet të parashtrihen në afat prej 24 orësh (në menyre elektronike) nga dita e luajtjes së ndeshjes . Arsyetimet e ankesës së bashku me dëshminë e pagesës dërgohen në afat prej 2 (dy) ditësh nga dita e luajtjes së ndeshjes, në dy kopje.

Për ndeshjet e 2 (dy) gjirove të fundit, si dhe ndeshjeve në play-off, ankesat paraqiten dhe dërgohen në afatin prej 24 orësh nga dita e luajtjes së ndeshjes.

Nëse afati i ankesës skadon në ditën e diele ose në ditë feste ai zgjatet deri në ditën e pare të punës. Vendimet mbi Ankesa në ndeshje sillen në afatin përfundimtar prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të ankesës, respektivisht 2 (dy) ditë nëse ankesa është në ndeshjet e dy gjirove të fundit ose ndeshjet e play-offit.

Ankesat në ndeshje i drejtohen Komisionit të Futsallit i cili i zgjedh në shkallën e parë.

TAKSA NË ANKESË

Neni 34.

Lartësinë e taksës së ankesës në të gjitha bazat e cakton KE i FFK në propozim të Komisionit të Futsal-it e cila është 100 €.Taksa i kthehet kërkuesit nëse ankesë plotësisht aprovohet .

Neni 35.

Ankesat e pa paralajmëruara, të vonuara ose jo plotësisht të taksuara nuk do të hyjnë në procedurë, por do të hodhën, kurse ndeshja do të regjistrohet me rezultatin e arritur.

Gjatë vlerësimit të afatit të ankesës ,merret parasysh dita në vulën postare, letrës rekomande ose telegram, data në vërtetimin e telefaksit ose data e fletëpagesës.

Neni 36.

Ankesat në vendime të Komisionit të Futsall-it i drejtohen Komisionit të Ankesave shkalla e dytë, në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës.

Për ndeshjet e dy (2) gjirove të fundit dhe ndeshjet e play-off-it, afati për ankesa është dy (2) ditë.

Nëse shkalla e dytë nuk e zgjidh ankesën në afatin e përcaktuar, konsiderohet se ankesa është miratuar në faktin se është rrëzuar vendimi dhe se është kthyer në rishqyrtim shkallës së parë.

REGJISTRIMI I NDESHJEVE

Neni 37.

Nëse në lojë nuk ka ankesë, dhe nuk ka arsye që ajo të regjistrohet me 2:0 (par forfe), ndeshja regjistrohet me rezultatin e arritur. Lojërat e mbajtura i regjistron Komisioni për gara me rregull më së voni në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e luajtjes.

Në rast se në ndonjë ndeshje është ngritur ankesë, afati për regjistrimin e ndeshjes zgjatet gjerë në sjelljen e vendimit të ankesës, respektivisht gjerë tek kryerja e vendimit të ankesës.

Ndeshja e regjistruar nuk mund të anulohet nga ana e Komisarit të garave, nëse vendimi është fuqiplotë ose në shkallë të dytë është sjellë vendim definitive.

TAKSA NË ANKESË

Neni 34.

Lartësinë e taksës së ankesës në të gjitha bazat e cakton KE i FFK në propozim të Komisionit të Futsal-it e cila është **100 €**.Taksa i kthehet kërkuesit nëse ankesë plotësisht aprovohet .

Neni 35.

Ankesat e pa paralajmëruara, të vonuara ose jo plotësisht të taksuara nuk do të hyjnë në procedurë, por do të hodhën, kurse ndeshja do të regjistrohet me rezultatin e arritur.

Gjatë vlerësimit të afatit të ankesës ,merret parasysh dita në vulën postare, letrës rekomande ose telegram, data në vërtetimin e telefaksit ose data e fletëpagesës.

Neni 36.

Ankesat në vendime të Komisionit të Futsall-it i drejtohen Komisionit të Ankesave shkalla e dytë, në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës.

Për ndeshjet e dy (2) gjirove të fundit dhe ndeshjet e play-off-it, afati për ankesa është dy (2) ditë.

Nëse shkalla e dytë nuk e zgjidh ankesën në afatin e përcaktuar, konsiderohet se ankesa është miratuar në faktin se është rrëzuar vendimi dhe se është kthyer në rishqyrtim shkallës së parë.

REGJISTRIMI I NDESHJEVE

Neni 37.

Nëse në lojë nuk ka ankesë, dhe nuk ka arsye që ajo të regjistrohet me 2:0 (par forfe), ndeshja regjistrohet me rezultatin e arritur. Lojërat e mbajtura i regjistron Komisioni për gara me rregull më së voni në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e luajtjes.

Në rast se në ndonjë ndeshje është ngritur ankesë, afati për regjistrimin e ndeshjes zgjatet gjerë në sjelljen e vendimit të ankesës, respektivisht gjerë tek kryerja e vendimit të ankesës.

Ndeshja e regjistruar nuk mund të anulohet nga ana e Komisarit të garave, nëse vendimi është fuqplotë ose në shkallë të dytë është sjellë vendim definitive.

PËRGJEGJËSITË DISCIPLINORE

Neni 38.

Për shkeljet disiplinore të cilat kryhen nga ana e klubeve, lojtareve, gjyqjetareve, trajnerët, ose punëtorët tjerë sportive në këto gara vendos Komisioni i Futsal-it, në bazë të neneve të Rregullores Disiplinore të FFK-së.

Dënimet për Super ligë; karton i kuq direkt 100 euro pas dy të verdhëve 50 euro.

Dënimet për ligën e parë; karton i kuq direkt 60 euro pas dy të verdhëve 30 euro.

Dënimet në të holla për lojtar, trajner dhe zyrtar të klubeve ma i ulëti 200 euro dhe ma i larti 400 euro, varësisht prej deliktit të bërë por gjithnjë duke u bazuar në rregulloren disiplinore të FFK-së.

PLOTËSIMI I LIGËS

Neni 39.

Super Liga e Kosovës në Edicionin 2022/2023 do të **ketë 10 klube**. (ose 9 klube) Në përfundimin e vitit garues 2022/2023 në tabelën përfundimtare pas përfundimit të kampionatit $9+9 = 18$ gjirosh, ligen e lëshojnë dy (2 **ose 1 nese jane 9 klube**) ekipet e renditura në fund të tabelës, kurse liga plotësohet me 2 (dy) ekipe nga Liga e Parë.

Neni 40.

Nëse nga ndonjë arsye para dhe gjatë kampionatit 2022/2023 zbrazet një ose më shumë vende, Super Liga nuk mund të plotësohet me ekipe.
(Vetëm Komiteti Ekzekutiv i FFK-së ka të drejten për plotsimin e liges më një vendim të veçantë).

PËRCAKTIMI I PLASMANIT

Neni 41.

Klubi i cili fiton ndeshjen fiton 3 (tri) pikë , tek barazimet secili ekip merr nga një pikë. Klasifikimi në tabelë përcaktohet me mbledhjen e pikëve të grumbulluara.

Nëse klubet kanë numër të njëjtë pikësh (nëse janë dy ekipe shikohen ndeshjet e ndersjellëta të dy ekipeve) nëse i kanë të barabarta atëherë vendos diferenca mes golave të pranuar dhe të shënuar. Në rast të golaverazhit të njëjtë, vendin më të mirë në tabelë e zë ekipi i cili ka shënuar më shumë gola, dhe nëse kanë shënuar njëjtë gola, shikohen ndëshkimet gjatë kampionatit, në rast të gjitha këto që u përmenden me lartë janë të njëjta, atëherë zhvillohet një ndeshje në teren neutralë për përcaktimin e plasmanit.

Tabelën e shpall Komisioni i Futsall-it.

PJESËMARRJA E KLUBEVE NË GARAT NDËRKOMBËTARE

Neni 42

Në gara ndërkombëtare që i organizon UEFA garat e klubeve, ne to obligativisht pjesëmarrës do të jetë: Kampioni i Super Ligës së Kosovës pas përfundimit të plej off-it i cili do të merr pjesë në Kupën e Kampionëve të Evropës

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET NGA GARAT

Neni 43.

Në gjitha ndeshjet e Super Ligës së Kosovës bëhet shitja e biletave të cilat i shtypin klubet sipas nevojave të tyre.

Fitimi nga biletat, reklama, shpalljet dhe aksionet tjera të marketingut nga ndeshjet kampionale të Super Ligës i mbledhin ekipet vendase.

Neni 44.

Klubet e Futsall-it i kryejnë pagesat të cilat caktohen me VENDIM nga KE i FFK-së :

- Për shfrytëzimin e palestrës ku luhen ndeshjet

- Dënimet në të holla sipas Vendimeve të komisionit të Futsall-it për lojtarë, persona zyrtar dhe anëtar të klubeve.

Gjithë pagesat bëhen përmes xhirosie:

TEBBANK Konto nr. 2011000186494471 FFK.

Neni 45

Afatet kalimtare për lojtar në futsal-it janë dy:

Afati veror pas përfundimit të kampionatit dhe afati dimëror pas përfundimit të pjesës së parë të kampionatit. Fillimin e afateve kalimtare e cakton Komiteti i FFK-së kurse në futsal mbaron 24 orë para fillimit të kampionatit. Lojtarët amator pa kontratë në afatin dimëror pa pëlqimin e klubit ku i zhvillon aktivitetet nuk ka të drejt të ndërroj mjedis (klubin).

TRANSFERET E LOJTAREVE

Neni 45a

Transferet e lojtareve prej një klubi në të tjetrin;

- Lojtarët vendor në Super ligë;.....50 €
- Lojtarët vendor në Lige të parë;.....30 €
- Lojtarët e huaj në Super ligë;.....100 €
- Lojtarët e huaj në Lige të parë;.....70 €

TRANSMETIMET

Neni 46

Ndeshjet e Super Ligës mund transmetohen edhe direkt nëpër mjet televizionit, kurse kjo kryhet me marrëveshjen mes TV , FFK-së dhe kontraktuesit.

Në rast të transmetimeve direkte ose incizimeve të ndeshjeve gjatë gjirove të rregullta, duhet të respektohen rregullat “e orëve të mbyllura” nga vendimet e UEFA-së. Përgjatimisht, transmetimet TV në orët e mbyllura me vendimin e UEFA-së për orët e mbyllura mund të realizohen me marrëveshjen e posaçme të klubeve dhe atë në programet televizive që i përcakton autori i të drejtave TV për edicionin 2022/2023 .

Klubet obligohen t’i përmbahen gjithë marrëveshjeve nga kontrata me partnerin TV, dhe posaçërisht të kujdesen që në palestër të mos jenë prezent kamerat e shtëpive televizive të cilat nuk kanë lejen e partnerit kontraktues për të drejtat televizive.

Klubet obligohen që t’i përmbahen rregulloreve për përdorimin e të drejtave promotive dhe mediale të FFK-së.

Në rast të thyerjes së këtyre vendimeve, klubet FFK-së do t’ia kompensojnë gjithë dëmin e shkaktuar dhe do të bartë sanksionet komfor rregullores Disciplinares të FFK-së për shkak të thyerjes së rregullave nga Propozicionet e garave.

Web faqja zyrtare është www.ffk-kosova.com (Aktivitete – Futsal)

SHPËRBLIMET

Neni 47

Kampioni i Kosovës në futsal shpërblehet me 5,000.00 €, kupë dhe 25 medalje.

Nënkampioni në futsal shpërblehet me 2000.00 €.

Fituesi i kupës të Kosovës shpërblehet me 1,000.00 €

Si dhe kupa me 25 medalje të arta të cilat ju ndahen lojtarëve, trajnerëve, mjekut dhe anëtareve të kryesisë sipas propozimit të klubit.

Finalisti i kupës të Kosovës shpërblehet me 500.00 €

Si dhe me 25 medalje.

Kampioni i liges se pare ne futsal shperblehet me 1,000.00 €

Nënkampioni liges se pare në futsal shpërblehet me 500.00 €.

Personave zyrtar (gjygtarëve dhe delegatit) medalje.

Protokollin e organizimit të ndeshjeve finale e përcakton Komisioni i Futsall-it i FFK-së. Gjithë pjesëmarrësit e ndeshjeve finale obligohen që në plotësi të respektojnë rregullat e Protokollit

PARTICIPIMET

Neni 48

Duke u bazuar që futsalli është një sport amator dhe për këtë shkak UEFA dhe FIFA e ndihmojnë me mjete financiare për zhvillimin e aktiviteteve nëpër mes të Federatave ku veprojnë.

FFK-ja do të participojë me mjete financiare për çdo ekip të Futsall-it në mbulimin e hargjimeve për personat zyrtar, delegate, kontrollor dhe gjygtar për ndeshjet kampionale dhe të kupës së Kosovës, gjithnjë duke u bazuar në planin financiar të Komisionit të Futsall-it i cili do të hartoj para çdo kampionati dhe do të ja paraqes Komitetit Ekzekutiv të FFK-së për aprovim.

Neni 49.

Ekipi mysafir duhet të respektoj ngjyrat e klubit vendas, e cila është paraqitur para fillimit të garave. Gjithë klubet e Futsall-it të Kosovës së paku 15 ditë para fillimit të garave, në formën e shkruar duhet të paraqes ngjyrat bazë dhe ato rezervë të ndërresave me të cilat do të garoj.

Klubi vendas paraqitet në ngjyrën bazë të paraqitur për ndeshje .

Klubi mysafir e ka të obligueshme të ketë ngjyrën dalluese nga ekipi vendase në të kundërtën e humb ndeshjen parfofe 2 : 0.

Ndërresa ose triko e një ekipi nuk duhet të jenë me ngjyrë të njëjtë dhe në shpinë të shënuara me numrat e lexueshëm nga 1-99 të vendosur në mes, lartësia mes 25 cm (njëzet e pesë) dhe 35 cm (tridhjetë e pesë centimetra),si dhe obligativisht të jetë numri identik edhe në brekë.

Portieri obligohet të bartë ndresë ose triko me ngjyrë dalluese nga ndërresat e bashkëlojtareve, lojtarëve kundërshtarë dhe gjygtarëve.

Numrat në ndërresa duhet t'i përgjigjen atyre në regjistrin e lojtarëve në Protokollin e ndeshjes, sipas "Rregullave të Futsall-it",komfor rregullës III.

Në ndërresë dhe brekë të ekipit gjatë ndeshjes duhet të veçohet me llogon zyrtare të klubit.

Klubet obligohen që të sigurojnë marker të ngjyrave të ndryshme (pancirë) nga pajisjet e tyre sportive ,të cilin ia dorëzojnë bashkëlojtarit gjatë zëvendësimit.

Lojtarët e dy ekipeve në bankinë duhet të kenë marker identik me ngjyra të dallueshme.

Klubi vendos obligohet që për foto reporter të siguroj shenjat e dukshme të cilat ata janë të obliguar t'i bartin gjatë kohës së ndeshjes. Lojtarët pjesëmarrës në ndeshjet kampionale obligohen që në krahun e djathtë të dresit të bartin shenjën-llogon e sponsorit eventual të Super Ligës, sponsori obligohet që me kohë përmes Komisionit të Futsall-it(KE të FFK-së) të siguroj shenjat. Çdo paraqitje në ndeshje me ndërresë pa shenjë do të trajtohet si shkelje e Propozicioneve dhe do të sanksionohet nga ana e Gjyqtarit Disiplinor.

TRUPAT E GARAVE

Neni 50.

Komisioni i Futsal-it – udhëheq me zhvillimin dhe politiken e futsal-it, njëherit kryen edhe detyrat e Shkalles së parë të Disiplinoret.

- Komisari i garave
- Komisari për referim

KOMISARI I GARAVE

Neni 51.

Komisari i garave:

- Udhëheq me garat e Super Ligës dhe Ligës së parë të Futsall-it ;
- Merr pjesë në përgatitjen dhe udhëheqjen e seminareve për delegat,
- Udhëheq me gara në harmoni me propozicionet dhe rregulloret e garave të vendosura nga ana e KE e FFK-së dhe të Komisionit për Futsall ;
- Cakton delegatët nga lista e delegatëve të Super Ligës dhe Ligës së parë të futsal-it
- Regjistron ndeshjet dhe ngrit procedurë ndaj shkelësve të rregullave komfor propozicioneve të garave ;
- Mban tabelën e garave ;
- Mban evidencën e lojtarëve me vërejtje dhe të njëjtit i paraqet në biltenin javor.
- Makton oraret, dhe lejon ndryshimin e terminëve të garave komfor Propozicioneve të garave dhe vendimeve të Kuvendit të KE të FFK-së;
- Përgatit propozimet për udhëzimet e organizimit dhe rregullat për ndeshjes
- Mban evidencën e suksesit të klubeve për Trofeun Fair Play dhe trofeun e Golashënuesit
- Kontrollon plotësimin e kushteve të Klubeve të Super Ligës dhe Ligës së parë të domosdoshme për mbarëvajtjen e garave
- Ngrit procedura ndaj pjesëmarrësve të garave të Futsall-it të cilët shkelin rregullat e këtyre Propozicioneve, Rregullores së Garave dhe Kodin e Mirësjelljes
- Përgatit dhe propozon gjithë aktet normative të nevojshme për gara ;
- Së paku dy (2) herë në vit raporton për punën e tij me propozime rreth masave eventuale për punë më të suksesshme
- Ngushtë bashkëpunon me Komisionin e Futsall-it, duke informuar gjithë faktorët në dhe jashtë organizatës.
- Përgatit dhe udhëheq seminarin dhe testimin për delegatët me lejen e Komisionit të Futsal-it.

KOMISARI PËR REFER

Neni 52.

Komisari për gjygtar:

- Merr pjesë në seminareve për gjygtar
- Cakton gjygtarët për ndeshje nga lista e gjygtarëve,
- Mban përkujdesin e referimit në gjithë ndeshjet e Super Ligës dhe Ligës së parë
- Përcjell referimin nëpërmes mjeteve të informimit;
- Mbledh dhe analizon procesverbalet dhe raportet e referimeve ,
- Informon organet përgjegjëse për masat e marra adekuate ,
- Ngritë fletëparaqitje dhe merr pjesë në analizimin e materialeve të fletëparaqitjeve zyrtare, ankesave dhe vërejtjeve në lidhje me referimin ,
- Së paku dy herë në vit, obligativisht me përfundimin e sezonit përpunon raportin për referim,
- Kryen edhe punë tjera të cilat ia besojnë organet e FFK-së,
- Ngushtë bashkëpunon me Komisionin e Futsall-it, duke informuar gjithë faktorët në dhe jashtë organizatës

GJYGJTARI DISCIPLINOR

Neni 53.

Gjygtari disiplinor:(Komisioni i Futsall-it)

zgjedh në shkallë të parë gjithë kundërvajtjet e kryera nga klubet e Futsall-it të Kosovës, lojtarët, trajnerët, gjygtarët, vëzhguesit dhe punëtorët e tjerë sportive, dhe në pajtim me rregulloren Disiplinore të FFK-së dhe kritereve për punën e gjygtarit disiplinor.

KOMISIONI PËR ANKESA (shkalla e dyte)

Neni 54.

Komisioni për Ankesa në shkallë të dytë zgjedh ankesat në vendimet e Komisionit të Futsall-it i cili i kryen edhe detyrat e gjygtarit disiplinor.

Ankesa në Vendimin e Komisionit të Futsall-it paraqitet në afatin e caktuar me Nenin 35 të Propozicioneve, kurse Ankesa në vendimin e Gjyqtarit Disiplinor në afatin prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit me postë rekomande ose telefaks me vërtetimin e pagesës së taksës së caktuar.

Vendimi i Komisionit për ankesa është përfundimtar.

DISPOZITAT TJERA

Neni 55.

Klubet pjesëmarrëse obligohen që të respektojnë rregullat e Propozicioneve të Garave, vendimet e organeve të garave si dhe parimet e Fair Play-it.

Neni 56.

Komisioni i Futsall-it ka të drejtë të shfrytëzoj materialet fotografike, audio-vizuale dhe vizuale të lojtarëve dhe personave zyrtar, si dhe emrin e klubit, emblemën dhe dresin e ekipit për çështje komerciale për qëllim të garave. Klubet me kërkesë dhe pa kompensim do t'i paraqesin Komisionit për Futsall materialin e caktuar si dhe dokumentacionin për promovimin e ligës. Në rast të ndeshjeve televizive, me anë të telefonit, internetit ose në ndonjë mënyrë tjetër, botimeve të rastit, albumeve me foto etj, ku përdoren emblemat, emrat e klubeve, fotografitë e trajnerëve dhe lojtarëve, përfitimi do të ndahet proporcionalisht tek të gjitha klubet. Komisioni i Futsall-it duhet të marr pëlqimin paraprak nga FFK për çdo aksion komercial.

Neni 57.

Gjithë klubet e Futsall-it të Kosovës obligohen para fillimit të kampionatit 2022/2023 të emërojnë komisionarët për çështjen e licencimit të klubit dhe me shkrim ta njoftoj Komisionin e Futsall-it dhe Komisararin e garave.

Për të gjitha rastet që nuk janë paraparë me këto propozicione vlejnjë Nenet e Rregullave të lojës "Futsal" vendimet e bordit ndërkombëtarë, Rregulloret e garave të FFK-së, dhe akteve dhe vendimeve të FFK-së dhe organeve të saja.

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 58.

Për shkeljen e këtyre Propozicioneve përgjegjësinë disiplinore e bartin gjithë klubet përgjegjëse, lojtarët, gjygtarët, delegati dhe zyrtarët tjerë, sipas Rregullave të Rregullores disiplinore të FFK-së.

Neni 59.

Për gjithë ato që nuk janë paraparë me këto Propozicione vlejnjë Rregullat e Futsall-it, Vendimet e BORD-it ndërkombëtar, Rregulloret e garave të FFK-së, dhe rregulloreve tjera të FFK-së.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 60.

Për Interpretimin e këtyre Propozicioneve është përgjegjës Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, kurse mes kuvendeve Komisioni i Futsall-it.

Neni 61.

Komisioni për Futsall obligohet që të ngris procedurën disiplinore, nëse ka dyshime të bazuara për rregullsinë e ndeshjes dhe shkeljeve (doping).

Neni 62.

Këto propozicione hyjnë në fuqi nga dita e aprovimit nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së .
Prishtinë, Shtator 2022

Kryetari i Komiteti Ekzekutiv të FFK-së
Agim ADEMI